



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 122, datë 10.09.2019

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZNJ. ARTA VORPSI NË VENDET VAKANTE PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, TË SHPALLURA NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018, KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DATËN 12.02.2018, PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 04.03.2019 DHE KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DATËN 04.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare/Relatore
Arta Marku	- Anëtare/Relatore
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare/Relatore
Fatri Islamaj	- Anëtar/Relator
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës **07.08.2019 dhe 09.08.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR GJYQTARE
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

Znj. Arta Vorpsi

OBJEKTI:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së znj. Arta Vorpsi, në vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 12.02.2018, Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019 dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi shqyrtoi relacionet e anëtarëve relatorë të Këshillit, **znj. Arta Marku, znj. Vitore Tusha, z. Fatri Islamaj dhe znj. Fatjona Memçaj**, dëgjoi mendimin e paraqitur nga **Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatës, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 54, datë 17.07.2019, ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatës Arta Vorpsi për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Sokol Berberi.
2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 57, në datën 17.07.2019 ka vendosur lejimin e kandidimit të zonjës Arta Vorpsi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 12.02.2018, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Vladimir Kristo.
3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 55, datë 17.07.2019, ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatës Arta Vorpsi për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Altina Xhoxhaj.
4. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 56, në datën 17.07.2019 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatës Arta Vorpsi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019, për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Bashkim Dedja.
5. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “*Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, secili nga anëtarët e Këshillit, znj. Arta Marku, znj. Vitore Tusha, z. Fatri Islamaj dhe znj. Fatjona Memçaj, në cilësinë e relatorit të vendeve vakante përkatësisht të treguar në pikat 1 deri 4 të këtij Vendimi, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

6. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidatja Arta Vorpsi në momentin e kandidimit dhe akteve e dokumenteve të tjera që janë administruar gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, secili nga anëtarët e Këshillit relator i vendeve vakante në të cilën kjo kandidatë ka paraqitur kandidaturën e saj, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të kësaj kandidatë për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese.

7. Në përfundim të procedurave të verifikimit dhe vendimeve të dhëna për lejimin ose ndalimin e kandidimit për të gjithë kandidatët në secilin vend vakant, relatorët përkatës të sipërcituar në pikën 5 të këtij Vendimi, kanë njoftuar Kryetarin dhe kanë paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për secilin kandidat të vendit vakant lidhur me procedurën e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidaturave.

8. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr. 112, në datën 07.08.2019 ka vendosur fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendet vakante, si më poshtë:

- a) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.
- b) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.
- c) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019.
- ç) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019.

9. Gjithashtu, me vendimin nr. 113 dhe nr. 114 të datës 07.08.2019, Këshilli ka miratuar kalendarin e intervistave me kandidatët e lejuar, si edhe listën e ekspertëve për gjuhët e huaja për dhënien e mendimit teknik për nivelin e zotërimit të tyre nga kandidatët.

10. Në mbledhjen e tij të datave 07.08.2019 dhe 09.08.2019, Këshilli shqyrtoi relacionet dhe procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore nga secili relator si edhe plotësinë e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim lidhur me secilin kandidat. Gjithashtu, Këshilli dëgjoi edhe mendimin e Avokatit të Popullit që, në thelb, nuk paraqiti vërejtje lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatës Arta Vorpsi.

11. Pas këtyre veprimeve, në vijim të mbledhjes, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit dhe nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, për katër vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të treguara në pikën 8 të këtij Vendimi.

12. Intervista mbi motivimin e kandidimit dhe nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja me kandidaten e lejuar, znj. Arta Vorpsi, kandidatë për të katër vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të treguara në pikën 8 të këtij Vendimi, u zhvillua në datën 09.08.2019.

13. Lidhur me nivelin e zotërimit të gjuhës angleze, të përzgjedhur nga vetë kandidatja e lejuar znj. Arta Vorpsi, në vijim të bisedës së zhvilluar në këtë gjuhë gjatë një pjese të intervistës, Këshillit i është paraqitur edhe mendimi me shkrim nga ekspertja e caktuar me vendimin nr. 113 datë 07.08.2019, Dr. Adelina Albrahimi, pedagoge e brendshme e gjuhës angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

14. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, mendimin e ekspertës për nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidatja Arta Vorpsi në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej saj sipas kërkesave të Këshillit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatës Arta Vorpsi për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

- a) në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës;
- b) në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të plotësuar, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këto dispozita, me kriteret e përgjithshme të vlerësimit të parashikuara në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016;
- c) në detajimin e mëtejshëm të kriterëve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimit më të hollësishëm të peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të treguar në Kreun II, në Kreun V dhe në Shtojcën 1 të Vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
- ç) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

Vjetërsia në profesion

15. Në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi “*Vjetërsia në profesion*”. Ndërkohë që, sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 8577/2000, përbën kusht lejimi kandidimi që kandidati të ketë së paku 15 vjet përvojë profesionale si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor të së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.

16. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë kohëzgjatjen për më shumë se 15 vjet të këtyre fushave të përvojës profesionale të secilit kandidat, në maksimum deri në 4 pikë, sikurse orientohet në tabelën e përshkallëzuar të pikëzimit të vjetërsisë në profesion të treguar në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

17. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Arta Vorpsi, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

- a) Asistent avokat, për periudhën 1996-1997;
- b) Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë për periudhën 1997-1998 pranë Gjykatë Kushtetuese;
- c) Nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike, Drejtore e Drejtorisë së Studimeve dhe Botimeve pranë Gjykatës Kushtetuese, për periudhën 2001-2005;
- ç) Këshilltare ligjore pranë Gjykatë Kushtetuese, për periudhën 2005 dhe aktualisht,
- d) Gjyqtare ad hoc, për periudhën 2015 e në vijim, pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ;
- dh) Lektore e jashtme e së drejtës kushtetuese, së drejtës kushtetuese të krahasuar, si edhe e të drejtave të njeriut, pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, Shkollës së Magjistraturës dhe në Shkollat e Larta Jopublike “Luarasi” dhe “Universiteti Evropian i Tiranës”.

18. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara, rezulton se në rastet e veprimtarive sipas shkronjës “c” dhe “ç” të pikës 17 të këtij Vendimi, kandidatja Arta Vorpsi ka ushtruar veprimtari profesionale në fushat e përcaktuara sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Ndërsa veprimtaritë sipas shkronjave “d” dhe “dh” janë të përfshira në të njëjtën periudhë kalendarike. Prandaj, në momentin e vlerësimit, kjo candidate ka gjithsej rreth **18 vjet dhe 8 muaj** vjetërsi në punë.

19. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “vjetërsia në profesion”, nisur nga ushtrimi i veprimtarive profesionale në një kohëzgjatje prej **18 vjet dhe 8 muaj**, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Arta Vorpsi me **1 (një) Pikë**.

Historiku Arsimit

20. Në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr.115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

21. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të për secilin kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

22. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Arta Vorpsi ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1996 si juriste, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

23. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe vetëdeklarimi i bërë nga kandidatja Arta Vorpsi, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare **9.2**.

24. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare **9.2** e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Arta Vorpsi me **2 (dy) Pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

25. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr.115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohen si kritere vlerësimi pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

26. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

27. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Arta Vorpsi ka ndjekur studimet pasuniversitare për Master të Nivelit të Dytë, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Vjenës, Austri, në periudhën 1998-1999 dhe me vlerësimin Pozitivisht (nuk aplikohet vlerësimi me notë), duke marrë titullin “Magister/Master i shkencave juridike”. Në vijim, ka ndjekur studimet pasuniversitare po në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Vjenës, Austri, në periudhën 1999-2001 dhe me vlerësimin “Pozitivisht” (nuk aplikohet vlerësimi me notë), duke marrë titullin “Doktor i Shkencave juridike (Doctor iuris)”. Sipas shkresës nr. 2110 prot./datë 06.04.2009 Komisioni i *Vlerësimit të Titujve Akademikë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës konfirmonte* se me vendimin nr. 160 datë 20.03.2009 grada shkencore e sipërcituar “është e barasvlefshme me gradën “doktor” në Republikën Shqiptarisë”.

28. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “gradë shkencore”, nisur nga marrja e gradës shkencore “Doktor i Shkencave Juridike” (Doctor iuris), Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Arta Vorpsi me **4 (katër) Pikë**. Meqenëse kjo gradë shkencore është fituar pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Vjenës, Austri, këtij vlerësimi i **shtohen 0.5 (zero pikë pesë) Pikë**. Në total, për këtë kriter vlerësimi i kandidatja Arta Vorpsi vlerësohet me **4.5 (katër pikë pesë) Pikë**.

29. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Arta Vorpsi ka ndjekur 13 veprimtari trajnimi afatshkurtra dhe disa për një

periudhë mbi dy javore, në pjesën më të madhe të tyre në Gjermani, Holandë, Itali dhe pranë GJEDNJ. Tematika e një pjesë të këtyre veprimtarive lidhet me të drejtat e njeriut, procesin e rregullt ligjor, të drejtën kushtetuese evropiane, impaktin dhe efektet e vendimeve të gjykatës kushtetuese etj.

30. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidatja Arta Vorpsi, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmon ta vlerësojë me **1.714 (një pikë shtatëqind e katërbëdhjetë) Pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

31. Në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.

32. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja, si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve, duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

33. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Arta Vorpsi zotëron dy gjuhë të huaja, Anglisht dhe Gjermanisht. Sipas deklaramit të kandidatës niveli i zotërimit të të dy gjuhëve të huaja është “shumë mirë” në të tre komponentët: të kuptuarit, të folurit dhe me shkrim. Për njohjen e gjuhëve të huaja janë paraqitur edhe dokumentet e lëshuara për zotërimin e tyre, ndërkohë që kandidatja ka ndjekur me kohë të plotë studimet afatgjata pasuniversitare 3 vjeçare në gjuhën gjermane, duke fituar edhe gradën shkencore “Doktor i shkencave Juridike” pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Vjenës, Austri.

34. Gjithashtu, gjatë intervistës së zhvilluar me Këshillin në datën 09.08.2019, për verifikimin e shkallës së zotërimit të gjuhës angleze, kandidatja Arta Vorpsi zhvilloi edhe bisedën me ekspertin e zgjedhur nga Këshilli, dr. Adelina Albrahimi. Në mendimin me shkrim të depozituar pranë Këshillit, ekspertja e njohurive të gjuhës angleze, në thelb, ka ardhur në përfundimin se kandidatja Arta Vorpsi shpalosi aftësi shumë të mira të të kuptuarit të gjuhës angleze, mund të kuptojë informacion teknik kompleks të lidhur me fushën ligjore pa vështirësi, komunikon shumë qartë në gjuhën angleze, duke u shprehur në mënyrë të saktë dhe koncize, përmes komunikimit të rrjedhshëm dhe përdorimit të terminologjisë së duhur në gjuhën angleze, duke sugjeruar vlerësimin e kësaj kandidateje me **3 (tre) Pikë**.

35. Për këto arsye, duke pasur parasysh mendimin me shkrim të ekspertes së vlerësimit të shkallës së zotërimit të gjuhës angleze me **3 (tre) Pikë**, si edhe faktin që kandidatja Arta Vorpsi zotëron edhe gjuhën gjermane me të cilën ka ndjekur me kohë të plotë edhe studimet afatgjata pasuniversitare 3 vjeçare pranë Fakultetit të Drejtësisë - Universiteti i Vjenës, për të cilën vlerësohet me **1 (një) Pikë tjetër**, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Arta Vorpsi për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **4 (katër) Pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

36. Në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

37. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh sipas vendimit normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

38. Në rastin e kandidates Arta Vorpsi, Këshilli shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të kësaj kandidateje në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

39. Për sa i përket *vlerësimit sasior*, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, Këshilli shqyrtoi edhe të dhënat e përditësuara të dërguara nga Gjykata Kushtetuese me shkresat nr. 272/1 datë 23.08.2019 dhe nr. 272/2 prot. datë 26.08.2019. Sipas të dhënave zyrtare të përcjella nga ky institucion, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese dhe të detyrës që ka ushtruar, për periudhën pesëvjeçare 08.10.2013 deri në 31.07.2018, rezulton se kandidatja Arta Vorpsi është ngarkuar që të përgatisë dhe ka relatuar gjithsej 197 çështje, për të cilat janë dhënë 43 vendime përfundimtare dhe 154 vendime moskalimi. Ndërkohë, kandidatja ka përgatitur relacion, opinion ligjor apo projektvendim edhe për 12 çështje të tjera, përfundimi i të cilave lidhet me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

40. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar rezulton se kandidatja Arta Vorpsi, në cilësinë e autores apo bashkëautores, ka përgatitur 12 publikime profesionale dhe kërkime shkencore, si edhe 25 artikuj të tjerë profesionalë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuara kryesisht në fushën e drejtësisë kushtetuese, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, sikurse tregohen më poshtë:

a) Publikime profesionale dhe kërkime shkencore:

- *“Komentar i reformës kushtetuese në sistemin e drejtësisë”*. Libër. Bashkëautore. Publikues : Instituti për Studime Publike dhe Ligjore dhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur Soros, 2019.

- “*Human Dignity in Albania*”. Botuar në: *Handbook of Human Dignity in Europe*. Libër. Autore e kontributit të cituar. Publikues: University of Lucerne dhe Springer Nature, Switzerland, 2019.
- “*Constitutional Justice in Albania*”. Botuar në: *Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism*. Libër. Autore e kontributit të cituar. Publikues: University of Regensburg dhe Springer Nature International., 2019.
- “*The Impact of proportionality test in protecting individual rights in Albania*”. Botuar në: *Constitutional Justice and Evolution of Individual Rights*. Libër. Autore e kontributit të cituar. Publikues: University of Regensburg, 2018
- “*Ankimi Kushtetues Individual – Përvoja gjermane dhe perspektiva shqiptare*”. Libër. Bashkëautore Publikues: Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ), 2017.
- “*Constitutional Courts and Ordinary Courts: Cooperation or Conflict?*”. Libër. Autore e kontributit të cituar. Publikues: University of Regensburg, 2017
- “*The Margin of Appreciation of the Albanian Constitutional Court on the Constitutionality of Emergency Decrees of Executive Power*”. Botuar në: *Rule of Law, Human Rights and Judicial Control of Power*. Libër. Autore e kontributit të cituar. Publikues: University of Regensburg, University of Santiago dhe Springer International Publishing, 2017
- “*Democracy and Constitutionalism – Still e tense relationship in new democracies*”. Botuar në: “*Transformation of Law Systems in Central, Eastern and Southeastern Europe in 1989-2015*”. Libër. Autore e kontributit të cituar. Publikues: Gdansk University Press, 2016
- “*Europeanization of Albanian Constitutional Law*”. Botuar në: “*Limitations of National Sovereignty through European Integration*”. Libër., Autore e kontributit të cituar. Publikues: University of Regensburg dhe Springer International Publishing, 2016
- “*Recent Developments in Albanian Constitutional Law*”. Libër. Monografi. Autore. Publikues: University of Regensburg, 2012
- “*Parime kushtetuese dhe të drejtat e njeriut në praktikën e Gjykatës Kushtetuese*”. Libër. Bashkëautore. Publikues: Universiteti i Tiranës dhe Fondacioni Konrad Adenauer, 2012.
- “*Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë*. Libër. Monografi. Autore. Publikues: Fondacioni Konrad Adenauer dhe Shtëpia Botuese “Maluka”, 2011.
- “*Rechtsstaat und Verfassungsgerichtsbarkeit – Ein vergleichender Ueberblick ueber oesterreichische und albanische Verfassungsgerichtsbarkeit*”. Punimi shkencor për mbrojtjen e titullit Doktor i Shkencave Juridike pranë Universitetit të Vjenës. Autore . Publikues: *Rechtswissenschaftliche Fakultät, Universitaet Wien*. 2001

b) Artikuj të tjerë të botuar brenda dhe jashtë vendit:

- “*Mbi përgjimin personal dhe të banesës si kufizim i privatësisë*” – reflektime mbi vendimin e Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane. Jeta Juridike Nr.1/2017, Shkolla e Magjistraturës, fq.147.
- “*Constitutional Justice and Politics – The review of constitutional amendments by the Constitutional Court in Albania*”, Raport i mbajtur në: XVIII International Congress on European and Comparative Constitutional Law, 14-15 October 2016, University of Regensburg.

- *“Konstitucionalizimi i së drejtës private dhe qasja e gjykatave shqiptare”*, Jeta Juridike Nr.4/2015, Shkolla e Magjistraturës.
- *“Constitutional courts and ordinary courts – Cooperation or conflict? Referat i mbajtur në Kongresin eXVII Ndërkombëtar për të Drejtën Kushtetuese Evropiane, Universiteti i Regensburgut, Gjermani 2015.*
- *“The influence of the Albanian Constitution in Private Law”*, Report held at XVlth International Congress on European and Comparative Constitutional Law, 13-14 October 2014, University of Regensburg.
- *“Recent Developments in European Constitutionalism in the Light of Constitutional Justice”*. Report held at XVth International Congress on European and Comparative Constitutional Law, May 31-June 1 2013, University of Regensburg.
- *“Ankimi individual në Gjykatën Kushtetuese shqiptare – Mjet juridik efektiv?”*, referat i mbajtur në Konferencën Shkencore Kombëtare “Mekanizmat mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të procesit të rregullt ligjor”, organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, 2012.
- *“Rishikimi i Kushtetutës”*, Revista Studime Juridike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Nr.1/2012.
- *“Die Aktivlegitimation politischer Parteien vor dem albanischen Verfassungsgericht”* botuar në revistën Osteuroparecht, organ i Deutsche Gesellschaft fuer Osteuropakunde in Zusammenarbeit, University of Cologne, Nr.1/2011.
- *“Roli i OJF-ve në forcimin e të drejtave dhe lirive themelore e interesave kolektive përmes gjyimit të zakonshëm dhe atij kushtetues”*, mbajtur në Konferencën Kombëtare: *“Roli aktiv i organizatave jofitimprurëse në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, përmes instrumenteve kushtetuese dhe ligjore*, (bashkëautore), organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, botuar në Proceedings Book, 2011.
- *“Akti normative me fuqinë e ligjit në këndvështrimin e së drejtës kushtetuese”*, botuar në revistën Jeta Juridike, Shkolla e Magjistraturës, 2010.
- *“Liria e shprehjes në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, botuar në revistën Tribuna Juridike, 2007.
- *“Ndalimi i torturës në shtetin e së drejtës”*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.30/2006.
- *“Aspekte kushtetuese të kufizimit të së drejtës së jetës - Rasti i “goditjes për vdekje” nga forcat e policisë”*, botuar në revistën Jeta Juridike, Nr.3/2006.
- *“Raporti kushtetues President – Parlament në republikën parlamentare”*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.29/2006.
- *“Referendumi shfuqizues dhe shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese”*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.31/2006.
- *“Mbi hapësirën e kontrollit të GJK lidhur me shqyrtimin e konflikteve zgjedhore sipas nenit 131/e të Kushtetutës”*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.35/2007.
- *“Interpretimi i Kushtetutës nga Gjykata Kushtetuese-Vendime interpretuese”*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.24/2005.
- *“Kuptimi i termit “interes i tyre” nga këndvështrimi i partive politike, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës”*, botuar në revistën Tribuna Juridike, Nr.51/2004.
- *“Mbrojtja ndërkombëtare e lirisë së besimit”*, botuar në revistën Tribuna Juridike, Nr.46/2004.
- *“Për imunitetin”*, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.19/2004.

- “Kur është vendimi i Kuvendit akt normativ?-opinion mbi një vendim të Gjykatës Kushtetuese”, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.21/2004.
- “Partitë politike dhe financimi i tyre nga shteti”, botuar në revistën E drejta parlamentare dhe politikat ligjore, Nr.16/2003.
- “Barazia para ligjit në praktikën e Gjykatës Kushtetuese”, botuar në revistën Jeta Juridike, Nr.1/2003.
- “Cronical of Albanian Constitutional Court's jurisprudence”, in Constitutional Law Review of East-European countries, University d’Auvergne, Law Faculty Clermont-Ferrand, Nr.2/2001.

41. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Këshilli vlerëson se në aspektin sasior kandidatja Arta Vorpsi ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Arta Vorpsi për këtë kriter ligjor vlerësimi me **4.571 (katër pikë pesëqind e shtatëdhjetë e një) Pikë.**

42. Për sa i përket *vlerësimit cilësor*, Këshilli shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Arta Vorpsi, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej saj, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionalë dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatës dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e saj në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Këshill dhe, më tej, për përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetues nga organet e emërtesës.

43. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, në datën 01.08.2019, kandidatja Arta Vorpsi ka njoftuar Këshillin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “*Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional*” dhe “*Kualifikimin Shtesë Profesional*”, ka përzgjedhur pesë dokumentet profesionale si më poshtë:

- a) Analizën e Kodit të Procedurës Penale lidhur me garancitë procedurale gjatë procesit penal.
- b) Analizë mbi pajtueshmërinë e kuadrit normativ të brendshëm me atë ndërkombëtar lidhur me pornografinë e fëmijëve.
- c) Ankimi Kushtetues Individual -Manual praktik.
- ç) Komentarin e ndryshimeve kushtetuese të reformës në drejtësi, faqet 143-212, 438-458.
- d) Constitutional Court and ordinary courts - Cooperation or conflict, fq.95-113.
- dh) The Europeanization of Albanian Constitutional Law, fq.165-183.

44. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Arta Vorpsi dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Këshilli shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë edhe ato të përmendura në Shtojcën nr. 1 të vendimit sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientime që

përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

45. Dokumentet profesionale të shqyrtuara trajtojnë tematika të ndryshme të fushës së të drejtës më fokus kryesor çështje të drejtësisë kushtetuese, aspekte të ndryshme të gjykimit kushtetues, shtrirjes dhe thellësisë së tij, aksesit të individit në gjykimin kushtetues, çështje të njohjes dhe respektimit të lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, procesit të rregullt ligjor, garancitë procedurale në procesin penal etj..

46. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është “*Origjinaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit*”. Nisur nga profilet profesionale të kandidatës Arta Vorpsi, përmbajtja e dokumenteve të analizuara, tematikës dhe dobisë së përdorimit të tyre nga profesionistë të fushës por edhe nga grupe interesi dhe publiku i gjerë, Këshilli vëren se pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në rastin e një numri publikimesh shkencore dhe artikujsh profesionalë, dëshmojnë qasje profesionale origjinale dhe të thelluara të çështjeve ligjore të përzgjedhura për trajtim, për të cilat jo vetëm në kohën e publikimit por edhe aktualisht ka një interes të veçantë për njohje dhe zbatim. Për rrjedhojë, krahas origjinalitetit në përzgjedhjen e tematikave dhe trajtimin e tyre duke sjellë argumente dhe përfundime me interes, vërehet edhe dobishmëria dhe impakti pozitiv i këtyre punimeve në praktikën gjyqësore, në zhvillimin e debatit profesional e doktrinar, si edhe njohjen e të drejtave nga publiku më i gjerë, përfshirë edhe për qëllimet praktike të përdorimit të ligjit në rastet kur mund të pretendojnë njohjen apo kërkojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

47. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Origjinaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **5.857 (pesë pikë tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) Pikë**.

48. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “*Aftësitë analitike*”, Këshilli vëren se posaçërisht pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në rastin e një numri publikimesh shkencore dhe artikujsh profesionalë, kandidatja Arta Vorpsi tregon zotërimin e aftësive të dallueshme për të analizuar informacione dhe për të identifikuar, arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore, parimet dhe institutet e së drejtës, dispozitat e së drejtës pozitive në trajtimin e çështjeve dhe problematikave që përbëjnë tematikën e punimeve dhe dokumenteve, sipas natyrës dhe qëllimit të vetë këtyre punimeve.

49. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë analitike*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **5.714 (pesë pikë shtatëqind e katërbëdhjetë) Pikë**.

50. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli shqyrtoi veçanërisht pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Arta Vorpsi, sikurse edhe publikime shkencore dhe artikujt profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidatës. Nga ky shqyrtim, Këshilli vëren se këto punime përmbajnë informacione të larmishme profesionale të përdorura dhe të lidhura efektivisht me natyrën, qëllimin dhe përmbajtjen e secilit prej punimeve të shqyrtuara, të nxjerra nga burime të ndryshme të doktrinë dhe praktikës gjyqësore vendase, si edhe prej atyre të shteteve të ndryshme dhe të institucioneve e gjykatave ndërkombëtare.

51. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **4 (katër) Pikë**.

52. Sipas treguesit “*Saktësia dhe precizoni*”, në thelb, verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur dhe materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme etj. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Arta Vorpsi, sikurse edhe i publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidates, Këshilli vëren se këto punime tregojnë nivel të shumë të lartë të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje, përdorim të pasur dhe korrekt të terminologjisë juridike dhe strukturim e përdorim në mënyrën dhe vendin e duhur të gjetjeve nga legjislati, doktrina, si edhe praktika gjyqësore shqiptare dhe e huaj.

53. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Saktësia dhe precizoni*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **4.857 (katër pikë tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) Pikë**.

54. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Qartësia*”, Këshilli shqyrtoi pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Arta Vorpsi, sikurse edhe publikime shkencore dhe artikujt profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidates. Këshilli vëren se në këto punime janë të organizuara dhe strukturuara në mënyrën e duhur, gjuha e përdorur është e pasur por njëkohësisht edhe korrekte, e thjeshtë dhe e një niveli të lartë profesional. Pasuria, qartësia e gjuhës së përdorur dhe organizimi i duhur i materialit i bëjnë këto punime të kuptueshme dhe të lexueshme, sipas natyrës së punimit dhe grupeve të interesit të cilave synon ti drejtohet.

55. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Qartësia*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **4 (katër) Pikë**.

56. Pas shqyrtimit dhe analizës së pesë indikatorëve të mësipërm që përbëjnë vlerësimin cilësor të dokumentacionit profesional të paraqitur nga kandidatja, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Arta Vorpsi me **24.428 (njëzet e katër pikë katërqind e njëzet e tetë) Pikë**.

C. Meritat profesionale – Kualifikimi Shtesë Profesional

57. Në shkronjën “b” të pikës 2 dhe shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe në sfera të tjera të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, përvojë të veçantë në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë, si edhe pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislati dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

58. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 12 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 8 pikë ekspertizën në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizën në fusha të tjera të veçanta të së drejtës. Gjithashtu, Këshilli vlerëson deri në 4 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

59. Në rastin e kandidatës Arta Vorpsi, krahas jetëshkrimit, intervistës dhe motivimit për kandidim, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të kësaj kandidateje në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë, pjesëmarrjet në veprimtari shkencore dhe veprimtari të tjera profesionale të lidhura me fushat e së drejtës.

Specializimi në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës

60. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizës në fusha të tjera të veçanta të së drejtës*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumente të tjera zyrtare mbi rezultate të vlerësimit profesional etj., si edhe nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Arta Vorpsi, Këshillit i rezulton se historiku dhe karriera profesionale e kësaj kandidateje është i fokusuar në pjesën më të madhe të kohëzgjatjes dhe shtrirjes së saj në fushën e drejtësisë kushtetuese, lirive themelore dhe të drejtave të njeriut.

61. Këshilli vjen në këtë përfundim jo vetëm nga fakti që veprimtaria profesionale e kësaj kandidateje është e lidhur për më shumë se 18 vjet me ushtrimin e detyrave profesionale pranë Gjykatës Kushtetuese (eksperte dhe drejtuese e studimeve juridike kushtetuese dhe më tej këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese), përvojë, e cila, e lidhur edhe me interesin e dëshmuar vetjak profesional, ka ndikuar në formimin profesional dhe specializimin e kësaj kandidateje në fushat e së drejtës kushtetuese dhe të drejtave të njeriut.

62. Nga ana tjetër, Këshilli vëren edhe se në formimin profesional, specializimin dhe ekspertizën e posaçme profesionale të fituar kandidatja Arta Vorpsi, një rol të veçantë ka edhe interesi i treguar për ushtrimin e vazhdueshëm të veprimtarive të tjera profesionale me kohë të pjesshme si lektore e jashtme e së drejtës kushtetuese, së drejtës kushtetuese të krahasuar, si edhe e të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, edhe studimet pasuniversitare të ndjekura me kohë të plotë për afat 3 vjeçar në Universitetin e Vjenës dhe doktoratura e fituar janë fokusuar tek çështjet e shtetit ligjor dhe juridiksionit kushtetues.

63. Së fundi, si rrjedhojë dhe reflektim i përgatitjes profesionale dhe përvojës së fituar në ushtrimin e detyrave profesionale, në cilësinë e autores dhe bashkëautores, kandidatja Arta Vorpsi ka realizuar edhe një numër të konsiderueshëm punimesh shkencore dhe artikujsh profesionale, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të cilat, në pjesën më të madhe të tyre, trajtojnë çështjet e juridiksionit kushtetues, ankimit individual dhe gjykimit kushtetues, të drejtës kushtetuese të krahasuar, aspekteve të ndryshme të lidhura me njohjen, respektimin

dhe mbrojtjen e lirive themelore e të drejtave të njeriut, procesin e rregullt ligjor, raportet kushtetuese mes pushteteve dhe organeve të tyre etj.

64. Nisur nga kjo veprimtari profesionale, Këshilli vlerëson se kandidatja Arta Vorpsi dëshmon jo vetëm formimin e saj të plotë juridiko-profesional, por edhe se ka arritur një nivel të spikatur dhe të dallueshëm, jo vetëm teorik por edhe të zbatimit e të ndikimit efektiv në praktikë, të specializimit dhe ekspertizës ligjore, veçanërisht të thelluar në fushën e të drejtës kushtetuese, të lirive themelore e të drejtave të njeriut, si edhe të aspekteve të ndryshme të juridiksionit kushtetues.

65. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut*” Këshilli vlerëson ti caktojë kandidates Arta Vorpsi **8 (tetë) Pikë**.

Angazhime profesionale shtesë

66. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues, *angazhimeve profesionale shtesë*, sipas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidates Arta Vorpsi, rezulton që për periudhën nga viti 2006 e në vijim, kjo candidate ka marrë pjesë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare duke prezantuar punime të saj, ka qenë pjesëmarrëse si përfaqësuese institucionale apo eksperte në projekte të ndryshme me fokus çështje të fushave të ndryshme të së drejtës të organizuara nga institucione të tilla si UNDP, UNWOMEN, UNICEF, Council of Europe; EURALIUS, EU Delegation, USAID, sikurse edhe në grupe pune me kontribute konkrete në procese legjislativë për hartimin e legjislacionit të organizuara nga Kuvendi, përfshirë edhe ato të Reformës në Drejtësi të finalizuar me ndryshimet kushtetuese dhe legjislacionin e ri të organeve të sistemit të drejtësisë.

67. Këto angazhime shtesë profesionale janë të lidhura me kontribute dhe pjesëmarrje në përgatitjen e analizave ligjore dhe studimeve mbi çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, të drejtat e fëmijëve, antidiskriminimi, barazia gjinore, aksesin në drejtësi, sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas, garancitë procedurale penale, të drejta ekonomike dhe sociale, organizimi i institucioneve kushtetuese, mirëfunksionimi i sistemit të drejtësisë, mirëqeverisja dhe funksionimi cilësor i administratës publike, antikorrupsioni, përafrimi i legjislacionit kombëtar me të drejtën e BE-së etj. Po kështu edhe në përgatitjen e projektakteve mbi dispozitat e reja kushtetuese mbi sistemin e drejtësisë dhe legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të miratuara në reformën kushtetuese të vitit 2016, projektakteve normative në fushat e ndihmës juridike, dispozitave të veçanta të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për lirinë e besimit fetar, për mbrojtjen nga diskriminimi etj.

68. Prandaj, duke pasur parasysh këto angazhime shtesë profesionale, të shtrira në kohë dhe me kontribute konkrete profesionale në disa nga fushat më të rëndësishme të së drejtës, Këshilli vlerëson që për kriterin vlerësues të “*angazhimeve profesionale shtesë*”, ti caktojë kandidates Arta Vorpsi **3.714 (tre pikë shtatëqind e katërbëdhjetë) Pikë**.

Meritat Morale

69. Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për “*integritetin etik e moral*”. Po kështu, në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 përcaktohen si kriter “*Rezultatet e*

vlerësimi të etikës së kandidatëve gjatë punës, nëse ka”, ndërsa në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përcaktohen si kritere vlerësimi edhe “*Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*” dhe “*cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi*”. Së fundi, në shkronjën “c” parashikohet si kriter vlerësimi edhe “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimi sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

70. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 30 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 18 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 10 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile . Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

71. Në rastin e kandidatës Arta Vorpsi, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatës me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimi të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatës, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimi të meritave morale të kësaj kandidateje.

Integriteti etik e moral

72. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *integritetit etik e moral*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatës me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimi, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidatja Arta Vorpsi në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon përkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt në komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e saj me dinjitet, duke dëgjuar dhe përgjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërmbytje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjet të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

73. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Këshillit nuk i rezulton që kandidatja Arta Vorpsi të ushtrojë apo të ketë ushtruar funksionet e saj profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që kjo kandidate të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me kolegët, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj.. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e saj në jetën profesionale dhe personale të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të gjyqtarit dhe sistemit të drejtësisë.

74. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “integritetit etik e moral” Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **17.714 (shtatëmbëdhjetë pikë shtatëqind e katërbëdhjetë) Pikë.**

Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

75. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidates me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidatja Arta Vorpsi në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave të saj për zbatimin e drejtë të ligjit sipas kompetencave dhe përgjegjësi që i ngarkon ligji.

76. Sipas të dhënave që disponohen vërehet se kandidatja ka ushtruar me seriozitet, maturi dhe besnikëri detyrimet profesionale në ushtrimin e funksioneve pranë Gjykatës Kushtetuese dhe reflekton angazhim të spikatur dhe përgjegjshmëri në angazhimet e saj profesionale jashtë ushtrimit të këtij funksioni. Gjithashtu, Këshilli vëren se nuk ka të dhëna që të tregojnë se kjo candidate në kryerjen e detyrës dhe në jetën personale të ketë kryer veprimtari që rezultojnë përtej kufijve ligjorë në raport me statusin dhe detyrat profesionale të kryera.

77. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e saj përmbush pritshmëri për marrjen e përgjegjësi ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilëve profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me kriterin vlerësues të “reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve” Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **9.428 (nëntë pikë katërqind e njëzet e tetë) Pikë.**

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

78. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidates me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se, përgjithësisht, kandidatja Arta Vorpsi nuk ka qenë e angazhuar në veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

79. Përtej vlerësimit të bërë në kriteret e tjera vlerësuese të trajtuara më sipër në këtë vendim, Këshilli vlerëson të evidentojë si kontribute në drejtim të çështjeve të ndjeshme për shoqërinë civile angazhimin e vazhdueshëm të kandidates jo vetëm në mësimdhënie, por edhe pjesëmarrjen e kësaj candidateje në diskutimin dhe përgatitjen e materialeve, analizave dhe projektakteve, në kuadër të projekteve të institucioneve të ndryshme, përfshirë ato ndërkombëtare, me elementë dhe problematika të ndjeshme për njohjen, promovimin dhe mbrojtjen e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut sikurse janë ato të barazisë gjinore, antidiskriminim, të drejtat e fëmijëve, rolin e OJF-ve në forcimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore etj.

80. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile” Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatës Arta Vorpsi **0 (zero) Pikë**.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

81. Në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016 parashikohen si kritere vlerësimi disa komponentë të lidhura me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatëve mbi çështjet e natyrës drejtuese, organizative, të kapacitetit për vendimmarrje, punës në grup, të komunikimit dhe përfaqësimit publik. Kështu, në pikën 3 të këtij neni parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:

- “a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin”;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- d) aftësitë e përfaqësimit publik.”

82. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

83. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 10 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 3 pikë *cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin* kandidatët, deri në 4 pikë *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*, deri në 2 pikë *aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*, si edhe me 1 pikë për *aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

84. Në rastin e kandidatës Arta Vorpsi, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatës me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatës, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të kësaj candidateje.

Cilësia e platformës dhe të vizionit

85. Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimin e kandidimit dhe vizionit të kandidatës Arta Vorpsi lidhur me qasjen dhe qëndrimet e saj mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, mbi sfidat kryesore me të cilat është përballur dhe duhet të përballlet Gjykata Kushtetuese në ushtrimin e përgjegjësve dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatës për çështjet që duhet të trajtohen me përparësi e në perspektivë për mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e kësaj Gjykate, për përballimin e sfidave me të cilat përballlet për shkak të mosfunksionimit të saj për një kohë të gjatë, si edhe nisur nga pritshmëritë që lindin nga ndryshimet e kompetencave dhe të juridiksionit në veprimtarinë e kësaj Gjykate. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Këshilli mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga kjo kandidatë gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Këshillit.

86. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Këshilli vëren se kandidatja Arta Vorpsi paraqiti një nivel shumë të lartë dhe të dallueshëm të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, si edhe të kësaj Gjykate në mirëfunksionimin e sistemit demokratik, ndarjes dhe balancimit të pushteteve, shtetit ligjor, respektimit të lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe në tërësi për zhvillimin ekonomik e social të vendit. Gjithashtu, kjo kandidatë parashtrori me maturi, në mënyrë profesionale, shumëplanëshe e të hollësishme çështje dhe problematika aktuale dhe të së ardhmes me të cilat duhet të përballlet Gjykata Kushtetuese dhe që kanë të bëjnë me thellësinë dhe shpejtësinë në shqyrtimin e çështjeve, me strukturën, organizimin dhe funksionimin e Gjykatës dhe përmirësimin e burimeve njerëzore, me mënyrat efektive të njohjes dhe afrimit të publikut me veprimtarinë e Gjykatës dhe të vendimeve të saj etj.

87. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur*” nga kandidatët, Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **3 (tre) Pikë**.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

88. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Këshilli mbështetet pikësisht në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësive dhe ushtrimin e vendimmarrjes në ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Gjithashtu, në vlerësimin e kandidatëve për këtë komponent vlerësimi, Këshilli mban parasysh se ushtrimi i çdo detyre, funksioni dhe veprimtarie profesionale, edhe kur formalisht nuk lidhet drejtpërdrejt me të drejtën/detyrimin për ushtrimin e kompetencës vendimmarrëse, gjithsesi përmban elementë që tregojnë aftësi të provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësitë si edhe vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

89. Në rastin e kandidatës Arta Vorpsi, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatës, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të kësaj kandidatëje për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

90. Këshilli vëren se kandidatja Arta Vorpsi, në karrierën e saj profesionale, ka ushtruar për periudhën 2001-2005 funksionin e Drejtores së Drejtorisë së Studimeve dhe Botimeve pranë Gjykatës Kushtetuese. Nga jetëshkrimi dhe të dhënat zyrtare rezulton se në pozicionit e drejtueses së kësaj strukture shumë të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese, kjo kandidatë ka ushtruar përgjegjësitë e bashkërendimit të punëve të kësaj Drejtorie, por edhe të të gjitha hallkave të Gjykatës, për përgatitjen e analizave mbi gjendjen dhe zhvillimin e sistemit juridik shqiptar dhe të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese, materialeve të ndryshme mbi vendimet më të fundit të gjykatave kushtetuese evropiane si dhe të GJEDNJ-së, përgatitjen e botimeve periodike të Gjykatës si dhe të botimeve të tjera të posaçme, organizimin dhe përgatitjen e seminareve dhe konferencave shkencore të Gjykatës Kushtetuese në bashkëpunim me gjykatat kushtetuese evropiane, Komisionin e Venecias, si dhe organizata të tjera vendase dhe të huaja etj.

91. Periudha kur kandidatja Arta Vorpsi ka ushtruar përgjegjësitë si drejtuese e Drejtorisë së Studimeve dhe Botimeve përkon me vetë fillimin dhe realizimin disa prej produkteve dhe veprimtarive më të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me materialet e shumëllojshme informuese, botimeve, veprimtarive dhe me krijimin e pasurimin e bazave të të dhënave mbi praktikën gjyqësore të aksesueshme për profesionistët dhe publikun e gjerë, të cilat kanë pasur impakt pozitiv dhe përbëjnë një model për tu respektuar nga institucionet e tjera.

92. Nga ana tjetër, veprimtaria profesionale si këshilltare ligjore e Gjykatës Kushtetuese dhe në veçanti, nisma dhe kurajo profesionale e përzgjedhjes së çështjeve të trajtuara, mendimet dhe zgjidhjet e sugjeruara për tematika të rëndësishme të fushës ligjore në punimet shkencore dhe artikujt e publikuar nga kjo kandidatë tregojnë të dhëna premtuese edhe për marrjen e përgjegjësiave dhe nismës për vendimmarrje, të cilat, së bashku me profesionalizimin kanë rëndësi thelbësore për ushtrimin e suksesshëm të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

93. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Arta Vorpsi me **2.571 (dy pikë pesëqind e shtatëdhjetë e një) Pikë**.

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

94. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me kolegët dhe palët, sikurse edhe në përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

95. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidates, Këshilli vëren se kandidatja Arta Vorpsi zotëron aftësi shumë të mira për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për tu përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

96. Gjithashtu, pa pasur qëllimin dhe pa marrë përsipër të tregojë se dallohet mbi të tjerët, nga materialet me shkrim dhe nga komunikimi e biseda gjatë intervistës, rezulton se kjo kandidatë zotëron edhe aftësi të shumë të mira për përfaqësimin publik, pra për të përfaqësuar atë që mendon se është e përbashkët me të tjerë në lidhje me një çështje apo kauzë të caktuar.

97. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*”, Këshilli e vlerëson kandidaten me Arta Vorpsi **2 (dy) Pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale

98. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, për vetë natyrën e këtij funksioni, mënyrës së funksionimit dhe kolegjalitetit të kërkuar në veprimtarinë e vendimmarrjen kësaj Gjykate, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë i përfshirë në punën në grup, me gjyqtarët e tjerë, këshilltarët dhe anëtarët e stafit të Gjykatës. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t’u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për tu përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

99. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatës, Këshilli vëren se kandidatja Arta Vorpsi zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore. Prezantimi dhe dokumentet profesionale dëshmojnë se kjo kandidatë është përfshirë vijë mësisht në projekte profesionale me kolegë të tjerë, vendas apo të huaj, për realizimin e publikimeve të shumta shkencore dhe artikujve profesionalë.

100. Gjithashtu, ushtrimi për një kohë të gjatë i funksionit të këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese, për vetë mënyrën kolegjiale dhe punën në grup që kërkohet në këtë Gjykatë për përgatitjen e çështjeve për shqyrtim, bisedimin e zgjidhjes së tyre dhe përgatitjen e vendimeve përkatëse, i kanë mundësuar kësaj kandidatëje fitimin e përvojës dhe shprehive të duhura për punën në grup dhe në çështje e situata të larmishme. Zotërimi i këtyre aftësive rezulton i reflektuar edhe në vetë mënyrën e parashtrimit me shkrim të çështjeve në platformën e paraqitur, si edhe në komunikimin e bisedën e zhvilluar me Këshillin gjatë intervistës.

101. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale*”, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatës Arta Vorpsi **1 (një) Pikë**.

Vlerësimi përfundimtar i kandidatës

102. Në përfundim të arsyetimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për vendet vakante në të cilat ka kandiduar, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i rezulton se kandidatja Arta Vorpsi vlerësohet në total me **89.610 (tetëdhjetë e nëntë pikë e gjashtëqind e dhjetë) Pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a, pikës 3 të nenit 7/b dhe pikës 4 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 239 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 67 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidates Arta Vorpsi me **89.610 (tetëdhjetë e nëntë pikë e gjashtëqind e dhjetë) Pikë**, në lidhje me kandidimin e saj për vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga :

- a) Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018,
- b) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 12.02.2018,
- c) Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019,
- ç) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019.

2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI



Mendim pakice

i anëtarës Margarita Buhali lidhur me vlerësimin me pikë të kandidatës Arta Vorpsi

Unë anetarja e KED **Margarita Buhali** kam votuar për një vlerësim të ndryshëm të kandidatës Arta Vorpsi në disa prej kriterëve të pikëzimit sipas vendimit nr.5/2019 dhe metodologjisë së miratuar me vendimin nr.51/2019 të KED. Ky qëndrim i ndryshëm, që unë kam pasur në raport me anëtarët e KED për vlerësimin e saj, sikurse rezultojnë edhe nga tabelat e pikëzimit të secilit prej anëtarëve të KED është rrjedhojë e të dhënave për të cilat KED ka ardhur në dijeni gjatë procesit të verifikimit dhe të vlerësimit të kësaj candidate, të cilat për mendimin tim duhet të ishin marrë në konsideratë edhe nga anëtarët e tjerë të KED për një vlerësim sa më objektiv të kandidatës në raport kjo edhe me kandidatet e tjerë. Kjo do të ndikonte detyrimisht edhe në një renditje të ndryshme të kandidatëve në secilën prej listave përkatëse të vendeve vakand të shpallur nga organet e emërtesës, pasi kandidatja Arta Vorpsi ka kandiduar në 4 vendet vakand për të cilat KED përgatiti listat e renditjes së kandidatëve në mbledhjen e datës 21.09.2019. Në total kam votuar që kjo candidate të vlerësohet me 76.5 pikë duke bërë një diferencim nga anëtarët e tjerë të KED në disa kriterë vlerësimi të metodologjisë. Bazuar në nenet 67 e 73 të vendimit nr.5 dt.02.04.2019 të KED paraqes mendimin tim lidhur me vlerësimin e kandidatës si më poshtë:

a- Lidhur me kualifikimet pasuniversitare konkretisht në komponentin e pikës 7 të metodologjisë së titulluar **“trajtime të tjera”** kam votuar për një vlerësim më të ulët për kandidaten konkretisht me 1 pikë pasi numri i trajtimeve të saj është dukshëm më i ulët se të gjithë kandidatët e tjerë. Konkretisht kjo candidate ka kryer vetëm 13 trajtime, nga të cilat vetëm 2 janë me një periudhë mbi dy javë, por janë me objekt vizitë studimore dhe kurs intensiv i gjuhës gjermane në vitin 1996. Për mendimin tim ky kurs nuk përfshihet në trajnimet e tjera sipas metodologjisë të miratuar, pasi nuk ka të bëjë me fushat e të drejtës, por me gjuhën e huaj për të cilën kandidatja është vlerësuar te kriteri i gjuhëve të huaja. Ndërkohë numri i trajtimeve për kandidatët e tjerë është në disa raste më shumë se 2 herë më i lartë. Kjo diferencë nuk është reflektuar drejtë nga KED në numrin e pikëve që i është dhënë kandidatës në kriterin e trajtimeve të tjera, pasi në këtë komponent ajo është vlerësuar pothuajse njëloj me kandidatët e tjerë ndërkohë, që diferenca negative e trajtimeve të kryera prej saj është e dukshme.

b-Vlerësimi sasior i punës së kryer nga kandidatja Arta Vorpsi sipas mesatares së pikëve 4,57 pikë të KED ose vlerësimeve personale që i kanë dhënë shumica e anëtarëve të KED nuk i përgjigjet qëllimit të vendimit nr.5/2019 dhe metodologjisë së miratuar me vendimin nr.51 dt.21.06.2019. Lidhur me këtë kriter KED në kohën e miratimit të vendimeve përkatëse ka pasur për qëllim të bëjë diferencën në ngarkesën e punë, që i është dashur të përballojnë secili prej kandidatëve në pozicionin e punës së ushtruar prej tij, pasi është një fakt i njohur se ngarkesa në punë shpesh pengon realizimin e botimeve shkencore nga specialist të ndryshëm të të drejtës ose arritjen e rezultateve më të larta në kriterin cilësor të arsytimit të akteve produktive të punës profesionale, ose realizimin e trajtimeve për përfitimeve të titujve shkencor. Në metodologjinë e miratuar me vendimin nr.51/2009 nga KED është theksuar se në vlerësimin sasior duhet të mbahet në konsideratë *një qasje krahasuese për produktin e punës së një kolegu mesatar duke filluar me një pikë e më pas të ndiqej metodologjia në varësi të tipologjisë së punimeve dhe dokumentave profesionale të kandidatit*. Pra, theksi është venë me prioritet vlerësimi të punës profesionale, që ka përballuar kandidati e cila duhet detyrimisht të diferencohet midis kandidatëve me qëllim që secili prej tyre të vlerësohet me objektivitet për ngarkesën reale, që i është dashur të përballojë në shërbim të drejtëpërdrejtë të interesit publik. Mbi këtë bazë llogjike ngarkesa në punë është ajo, që duhet të mbahet në konsideratë

në vlerësimin në pikë të kriterit sasior në raport me botimet shkencore, e cila me përjashtim të profesorëve e lektorëve të punësuar të të drejtës, është një produkt vullnetar i veprimtarisë personale të cdo specialisti të të drejtës. Në shumicën e rasteve juristët e praktikës sic janë gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët e tjerë, që janë të lidhur drejtëpërdrejtë me veprimtarinë gjyqsore, inspektuese ose hartuese të ligjeve për shkak të ngarkesës në punë e kanë të pamundur të bëjnë botime shkencore, ndërkohë kur realisht cdo vendim ose akt i mbajtur prej tyre është në vetvete një punim shkencor, madje me një shkallë të lartë përgjegjësie, në ndryshim nga botimi shkencor që është një produkt vullnetar i autorit. Prandaj për mendimin tim ajo, që duhet të mbahet në konsideratë në vlerësimin e kriterit sasior të kandidatit është ngarkesa në punë, që ai realisht ka përballuar në angazhimin e tij profesion brenda detyrës, që ka mbajtur.

Duke iu rikthyer vlerësimin sasior të punës së kandidatës Arta Vorpsi konstatohet se puna e kryer nga kandidatja në 5 vitet e fundit ka qënë ajo e këshilltares në gjykatën kushtetuese dhe në këtë detyrë ajo ka realizuar opinion këshillimor **në 30-33 çështje në vit**. Nga ana tjetër nuk rezulton që opinionin i saj në këto 30 çështje të ketë kërkuar një anazhim të lartë kërkimor dhe arsytues, pasi nuk janë paraqitur në KED këto opinione dhe për më tepër kandidatja në 5 dokumentat e saj e përzgjedhura për vlerësim nuk ka përfshirë asnjë opinion për tu vlerësuar si produkt të punës së saj në kriterin cilësor. Pra, rezulton se sasia e punës e matshme për këtë kandidate është dukshëm më e ulët se ajo e kandidatëve të punësuar në pozicione të ndryshme pune nga ajo e këshilltarit të gjykatës kushtetuese. Prandaj kam vlerësuar këtë kandidate në këtë komponent me pikë pak mbi nivelin mesatar të këtij komponenti, konkretisht me 3 pikë. Nëpërmjet këtij vlerësimi kam pasur si qëllim që të bëhej diferenca e punës, që secili kandidat ka kryer, duke marr vlerësimin përkatës. Pikërisht kjo diferencë nuk është reflektuar në vlerësimin sasior të punës së kandidatës Arta Vorpsi pasi konstatohet se shumica e anëtarëve të KED kanë vlerësuar me maksimumin e pikëve kandidaten në këtë kriter (5 pikë) duke sjellë në përfundim për shkak të mbledhjes matematike, një diferencë të vogël të saj nga kandidatët e tjerë, ndërkohë që ngarkesa e punës, e këtyre të fundit është dukshëm më e lartë.

Fakti se ngarkesa e punës së këshilltarëve të gjykatës kushtetuese varet nga prurjet e çështjeve në gjykatën kushtetuese, nuk mund të coj në rritjen e pikëve në vlerësimin sasior të punës së kandidateve, që kanë punuar pranë kësaj gjykate. Vlerësimi i kriterit sasior në punë ka të bëjë pikërisht me diferencimin e ngarkesës në punë, që mbajnë specialistët e fushave të ndryshme të të drejtës duke i thënë prioritet specialistëve të praktikës, që përballojnë një ngarkesë më të madhe pune, gjë që i pengon ata në realizimin e botimeve shkencore cilësore ose në përfitimin e titujve akademik ose në realizimin e trajnimeve profesionale e shkencore. Në këto kushte pikët që kandidatët me ngarkesë të madhe pune, duhet të marrin në kriterin vlerësimin sasior detyrimisht duhet të jenë më të larta se ato të kandidatëve të tjerë, të cilët për shkak të institucionit, ku punojnë përballojnë një ngarkesë më të ulët pune profesionale dhe kanë më shumë mundësi të bëjnë kërkime shkencore dhe trajtime profesionale duke fituar grada shkencore. Këto të fundit reflektohen në metodologji me pikë më të larta në kriteret e tjera si tituj e grada ose specializime në fusha të të drejtës kushtetuese. Për me tepër konstatohet se në 5 vitet e fundit botimet e kandidatës janë vetëm 6 akte, gjë që përbën një numër I cili gjithsesi nuk ndikon në rritjen e kriterit sasior të punës së saj.

Gjithashtu ngarkesa e pakët në punë e këshilltareve të gjykatës kushtetuese, kategori ku përfshihet edhe kandidatja Arta Toska, nuk ka ndikuar në rritjen e shpejtësisë së shqyrtimit të çështjeve në gjykatën kushtetuese ose në arsytimet e vendimeve të kësaj gjykate. Është një fakt i njohur vonesa e arsytimit të vendimeve në gjykatën kushtetuese, të cilat kanë shkaktuar probleme madje edhe në hyrjen në fuqi për zbatim të këtyre vendimeve. Puna e kërkimore dhe opinionet e dhëna nga kandidatet për këshilltare ndikojnë drejtëpërdrejtë në

shpejtësinë e punës së gjykatës në tërësi. Nisur nga kjo e dhënë rendimenti i punës së kandidatës me vetëm 30-33 çështje në vit është dukshëm i ulët edhe duke marrë për bazë numrin e çështjeve të shqyrtuara për njësi kohore. Prandaj për mendimin **tim vlerësimi sasior me 3 pikë** për kandidaten A.Toska prej meje është bërë në përputhje me ngarkesën e punës së provuar që ajo realisht ka përballuar, e cila në fakt është dukshëm më e ulët se e kandidatëve të tjerë që vijnë nga rradhët e prokurorisë, gjyqsor ose inspektoriatit. Përderisa KED në vendimin nr.5/2019 kishte vendosur për të përgatitur një listë të vetme edhe në ato raste kur kishte më shumë se një vend vakand pranë të njëjtit organ emërtese, KED duhet të bënte detyrimisht vlerësimin e kriterit sasior dhe të kriterëve të tjera të kandidatëve në rafshin krahasimor, pasi vetëm kështu do të justifikoheshin renditja në një listë të vetme e kandidatve që vijnë nga kategori të ndryshme sic janë magjistratët dhe juristët. Nisur nga kjo llogjikë bie në sy se ngarkesa në punë e kandidatës si këshilltare ka qënë më e ulët se e kandidatëve të kategorive të tjera profesionale. Ndërsa është pak më e lartë se e një kandidatje tjetër po ashtu këshilltare në gjykatën kushtetuese. Pikërisht për këtë diferencë e kam vlerësuar kandidaten A.Vorpsi me 3 pikë.

c- Për kriterin e **vlerësimit cilësor** të 5 dokumentave të zgjedhura, në pikëzimin e dhënë për kandidaten A.Vorpsi rezulton se përsëri ka diferencë në komponentët i-origjinaliteti e impakti, ii-aftësia analitike, iii-saktësia e precizioni, që ka sjellë edhe në vlerësimin me 21 pikë nga 25 të mundshmet. Megjithëse diferenca në këtë rast prej meje nuk është shumë e dukshme në raport me anëtarët e tjerë të KED do të doja të prezantoja disa qëndrime për këtë vlerësim.

Kandidatja A.Vorpsi ka paraqitur këto dokumenta:

1. Analizën e Kodit të Procedurës Penale lidhur me garancitë procedurale gjatë procesit penal.

2. *Analizë mbi pajtueshmërinë e kuadrit normativ të brendshëm me atë ndërkombëtar lidhur me pornografinë e fëmijëve.*

3. *Ankimi Kushtetues Individual -Manual praktik.*

4. *Komentarin e ndryshimeve kushtetuese të reformës në drejtësi, faqet 143-212, 438-458.*

5. *Constitutional Court and ordinary courts-Cooperation or conflict, fq.95-113.*

6. *The Europeanization of Albanian Constitutional Law, fq.165-183.*

Pamohuar vlerat, që secili prej punimeve shkencore ka në sistemin e drejtësisë, rezulton se kandidatët kanë diferencë në shkrimin e dokumentave të përzgjedhura prej tyre duke u reflektuar kjo edhe në impaktimin e këtyre dokumentave në fushën e të drejtës, origjinalitetin, saktësinë në identifikimin e problematikës juridike dhe aftësinë analitike në zgjidhjen e çështjes. Kandidatja Arta Vorpsi ka përzgjedhur për vlerësimin e kriterit cilësor vetëm botime juridike ose studime, që në fakt janë veprimtari të kryera jashtë sferës së saj profesionale si këshilltare në gjykatën kushtetuese. Realizimi i botimeve shkencore megjithëse ka vlerë në pasurimin e debatit juridik, kurrsesi nuk mund të luajnë një impakt të drejtëpërdrejtë në praktikën gjyqsore ose në zhvillimin e mëtejshëm të legjislacionit, në raport me rastet kur dokumenti i përzgjedhur është i lidhur drejtëpërdrejtë me punën e realizuar nga kandidatja. Duke qënë se kjo kandidatë konkuron për gjyqtare në gjykatën kushtetuese përzgjedhja e dokumentave prej saj për vlerësim nga KED nuk mund të linte jashtë dokumenta, që janë produkt i punës së drejtëpërdrejtë prej saj si këshilltare në gjykatën kushtetuese, ku ajo synon të emërohet. Vetëm nëpërmjet këtyre dokumentave KED mund të identifikonte nëse kandidatja gjatë punës së saj si këshilltare ka qënë të afta të eidentojë problemet, që janë shtruar për zgjidhje para gjykatës kushtetuese, dispozitat kushtetuese të shkelura, aftësinë e tyre analitike e saktësinë e opinionit të dhënë për zgjidhjen e çështjes. Në rastet e botimeve shkencore eidentimi i këtyre komponentëve është më i pamundur për tu dalluar, pasi në një punim shkencor hartuesi parashtron opinionin e tij në mënyrë të lirë pa mbajtur peshën e

përgjegjesisë për ndonjë ndikim, që mund të shkaktojë ky dokument në të ardhmen. Për botimet shkencore vlerësimi i mbetet vetëm lexuesve të fushës përkatëse të të drejtës, që në varësi të vlerësit personal mund t'i përdorin këto shkrime si referenca ndihmuese në punën e tyre të përditshme. Në këtë këndvështrim kandidatja Arta Vorpsi si këshilltare e gjykatës kushtetuese duhet të përfshinte në dokumentat e përzgjedhur edhe produkte të drejtëpërdrejta të punës së tyre profesionale me qëllim që në përputhje me nenin 240 të ligjit nr.115/2016 dhe nenin 7/a të ligjit nr.8577/2000 të ndryshuar të evidentohet aftësia e saj në secilin prej komponentëve vlerësues të kriterit cilësor të shkrimeve, duke qënë se kandidon për anëtar të gjykatës kushtetuese dhe puna e saj profesionale ka qënë e lidhur drejtëpërdrejtë me vendimmarrjen e kësaj gjykate.

Megjithë aftësinë kërkimore që është e dallueshme te kandidatja Arta Vorpsi aftësia për të për evidentimin e problemeve e për më tepër në shfaqjen hapur të mendimit për zgjidhjen e tyre juridike, analiza analitike për arritjen e konkluzioneve në dokumentat e përzgjedhura nuk mund të identifikohet se arrin shkallën maksimale të vlerësit të këtij kriteri. Shpesh punimet shkencore janë një panoramë e qëndrimeve të mbajtura nga gjykata kushtetuese për çështje të shtruara para saj ose përmbledhje e vendimeve të gjykatave të huaja, gjë që vlerësohet te kriteri i aftësive kërkimore të kandidatës, por jo te kriteri i aftësive analitike dhe precizioni i evidentimit dhe zgjidhjes së problemit. Në dokumentat e zgjedhura përgjithësisht nuk reflektohet probleme të interpretimit të ndryshëm në praktikë të dispozitave ligjore, por edhe në rastet kur evidentohen çështje të diskutueshme kandidatja parashtron mendimin e saj më shumë në formën e opionioneve për zgjidhje, por pa dhënë një mendim të qartë, kategorik e bindës mbi zgjidhjen e çështjes sipas këndvështrimit të saj. Pra shfaqja e mendimit prej saj prezantohet në shumicën e rasteve në formën e një këshille ose mendimi të diskutueshëm dhe jo preciz. Nisur nga ky perceptim vlerësoj se pikët maksimale të kandidatës në kriterin e cilësisë duhet të jenë 21 pikë.

d- Lidhur me angazhimet shtesë profesionale i vlerësuar sipas metodologjisë ky komponent me 4 pikë, cmoj se kandidatja A.Toska edhe në këtë kriter duhet të vlerësohet me 2 pikë, duke mbajtur kështu një qëndrim të ndryshëm nga anëtarët e tjerë të KED. Kështu angazhimet shtesë të kandidatës A.Toska janë kryesisht në fushën e lektorit të të drejtës ose të ekspertëve në trajnime të organizuara nga institucione të ndryshme e në ndonjë rast pjesë e konsulentëve të grupit për reformën në drejtësi për periudhën Janar 2015 deri në Qershor 2016. Ndërkohë kandidatet e tjerë, që konkurojnë në të njëjtin vend vakant për gjykatë kushtetuese, në kuadër të angazhimeve shtesë kanë ngarkesa më të shumta si përballuar angazhime të ndryshme si eksperte trajnuese, lektore e të drejtës në universitet, shkollë të magjistraturës, anëtare e të komisioneve, bordeve organizmave ndërkombëtar etj. Të gjitha këto angazhime shtesë të kandidatëve të tjerë janë dukshëm më të lartë se ajo e kandidatës A.Toska dhe e këshilltareve të tjera të gjykatës kushtetuese. Kjo diferencë midis kandidatëve në angazhimet shtesë, justifikon vlerësimin më të ulët me pikë për këtë kriter për këtë kandidatë në raport me kandidatet e tjera, që konkurojnë në vendet vakant të gjykatës kushtetuese, pasi vetëm kështu mund të bëhet diferencimi me pikë i tyre për të njëjtin kriter, gjë që ndikon në përfundim edhe në renditjen e tyre në listën, që i dërgohet organeve të emërtesës.

e-Lidhur me kriterin e integritetit moral kam vlerësuar se kandidatja Arta Vorpsi duhet të merrte një vlerësim më të ulët se maksimalja e pikëve të këtij kriteri, konkretisht e kam vlerësuar me 16 pikë nga 18 të mundshmet, duke bërë edhe këtu një diferencim të saj me gjithë kandidatët e tjerë të vlerësuar prej meje dhe me pikët që i kanë dhënë anëtarët e tjerë të KED në këtë kriter. Në përcaktimin e këtij vlerësimi kam mbajtur në konsideratë e besueshmërinë e reflektuar prej saj në intervistimin e realizuar nga KED. Kështu gjatë intervistët kjo kandidatë është pyetur prej meje lidhur me numrin e pikëve, që ka marr në

provimin e këshilltarëve në shkollën e Magjistraturës dhe mendimin që ajo kishte mbi rezultatet në këtë provim. Kandidatja referoi se pikët e provimit të saj ishin dhënë në vendimin e marr nga KPK për konfirmimin e saj në detyrë dhe tregoi para KED vetëm pikët, që ajo kishte marr në testin profesional dhe jo në testin e përgjithëshëm paraprak kualifikues, ndërkohë që sipas rregullores së shkollës së magjistraturës konsiderohen fitues kandidatët, që kanë marr më shumë se 60 % të pikëve në secilin prej provimeve. Ndërkohë nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të KPK prej meje si anëtare u konstatua përsëri se në vendimin nr.76/2018 të KPK ishin dhënë vetëm pikët e testit profesional dhe jo ato të testit të përgjithëshëm. Qëndrimi i mbajtur nga kandidatja në intervistim duke shmangur përgjigjen për vlerësimin konkret të dhënë nga shkolla e Magjistraturës për testin e përgjithëshëm, megjithëse u pyet drejtpërdrejtë, ndikon në uljen e perceptimit për shkallën e transperencës dhe besueshmërisë të reflektuar nga kandidatja. Prandaj nisur nga ky perceptim vlerësoj se në kriterin e integritetit personal, kandidatja duhet të vlerësohet me 16 pikë .

f-Për sa i përket **kriterit të reputacionit** të kandidatës Arta Vorpsi kam cmuar se ajo duhet të vlerësohet me një sasi prej 6 pikësh nga 10 të mundshmet, duke mbajtur edhe në këtë kriter një qëndrim të ndryshëm nga anëtarët e tjerë të KED. Ky diferencim vjen për faktin se kandidatja A.Vorpsi nuk kanë kaluar provimin e shkollës së magjistraturës e parashikuar nga neni E i Kushtetutës dhe neni 42 i ligjit nr.84/2016. Vlerësimi i saj me rezultat negative nga shkolla e Magjistraturës cënon imazhin publik për aftësitë e saj profesionale për të qënë anëtare të gjykatës kushtetuese, pasi me rezultatit e arritur në shkollën e Magjistraturës kjo kandidatë nuk plotëson kriteret për të qënë gjyqtare në nivelin e shkollës së parë. Ligjvënësi vlerësoi që për këshilltarët të verifikoheshin aftësitë profesionale edhe me provim nga shkolla e Magjistraturës, në ndryshim kjo nga magjistratët për të cilët aftësitë profesionale në këtë drejtim u konsideruan të prezumuara. Shkolla e Magjistraturës nga gjithë institucionet ndërkombëtare vlerësohet si një histori sukcesi në Shqipëri. Prandaj rezultati negativ i kandidatës Arta Vorpsi në provimin e shkollës së Magjistraturës është një rrethanë, që ndikon në uljen e drejtpërdrejtë të besimit të publikut në aftësitë profesionale të saj si kandidatë dhe të vetë Gjykatës Kushtetuese në tërësi, pasi do të vihet në dyshim aftësitë profesionale të anëtarëve të gjykatës kushtetuese në raport me atë të gjykatave të zakonëshme, të cilat në përputhje me nenin 145 të Kushtetutës kanë të drejtë të pezullojnë gjykimet duke e dërguar ligjet për verifikimit të kushtetueshmërisë në këtë gjykatë. Prandaj për mendimin tim **rezultati negativ i shkollës së magjistraturës në provimin e vlerësimit të aftësive profesionale duhet detyrimisht të merrej në konsideratë duke u reflektuar në uljen e pikëve në këtë kriter**. Pavarësisht se kandidatja ka marr më pak pikë në testin e vlerësimit të përgjithëshëm të shkollës së magjistraturës dhe jo në testin profesional, pyetjet e testit të përgjithëshëm përfshijnë edhe pyetje të karakterit të njohurive të përgjithëshme juridike, madje përfshijnë pyetje llogjike, të cilat evidentojnë aftësinë analitike e llogjike të kandidatëve. Për mendimin tim kjo rrethanë duhet të ishte marrë në konsideratë për pikëzimin e kandidatës në kriterin e reputacionit, pasi ndikon drejtpërdrejtë edhe në imazhin publik të gjithë institucionit të Gjykatës Kushtetuese në tërësi.

Për sa mësipër

Bazuar në nenin 240 të ligjit nr.115/2016, nenin 125 e 149/d të Kushtetutës, nenin 67 e vijues të vendimit të KED nr.5/2019

Mendimi im i ndryshëm nga anëtarët e tjerë të KED për vlerësimin e kandidatës Arta Vorpsi është se ajo duhet të vlerësohet në total me 76,5 pikë.

Anëtare
Margarita Buhali

